




Melanoma

Kanceri i zi i lëkurës



Lëkura

Lëkura është organi më i madh dhe më i rëndë i njeriut. Ajo i mbron organet e brendshme nga ndikimet e jashtme, si vapa, lagështira ose presioni (trysnia), shmang shkaktarët e sëmundjeve dhe rregullon temperaturën e trupit. Lëkura është e ndërtuar nga shtresa dhe qeliza të ndryshme.

Ekzistojnë disa lloje kancerësh lëkurorë: melanoma, (kanceri i zi i lëkurës) dhe format non-melanocitare, të ashtuquajturat forma të çelëta të kancerit lëkuror (spinalioma, bazalioma). Këto sëmundje zhvillohen në mënyra të ndryshme prandaj edhe trajtohen në mënyra të ndryshme. Për pasojë, në vazhdim bëhet fjalë vetëm për melanomën.

Nocionet «Melanomë» dhe «kancer i lëkurës» shpesh përdoren si sinonime, pasi që melanoma, ndryshe nga format «e çelëta» të kancerit lëkuror, është natyrëkeqe (malinje) dhe mund të formojë metastaza. Për këtë shkak ndonjëherë flitet edhe për melanomën malinje. Ajo zë fill në ato qelizat lëkurorë të cilat gjatë nixirjes në diell formojnë pigmentin e errët (melanocitin).

Incidenca

Në Zvicër për çdo vit sëmuren rreth 1800 veta nga një melanomë. Këta përbëjnë 5% të të gjitha sëmundjeve

kanceroze; në këtë mënyrë melanoma i përket llojeve më të shpeshta të kancerit. Mund të paraqitet madje edhe tek personat më të rinj: një e treta e pacientëve dhe pacientëve janë më të rinj se 50 vjeç.

Dekadave të fundit dendësia e përhapjes së melanomës është shtuar dukshëm. Kjo shpjegohet në radhë të parë me faktin se njerëzia në kohën e sotme e ekspozojnë lëkurën në diell dhe rreziten shumë më tepër se sa në kohët e shkuara.

Simptomat

Shumë nga melanomat krijohen nga ndonjë lezion i pranishëm në lëkurë. Shenja të mundshme janë:

- > Zmadhimi ose rritja e një nishani; nishanet me përmasa më të mëdha se sa 5 mm duhen kontrolluar
- > Kufizimi ose ngjyrimi i parregullt i një nishani, ndryshimi i ngjyrës ose formës së tij
- > Kur një nishan kruhet, nxjerr gjak ose pezmatohet

Një melanomë shpesh shfaqet si një nyjë blu e errët ose bojëkafe, ose si një ngjyrim lëkuror zonal bojëkafe, i cili zgjerohet. Mirëpo ekzistojnë dhe melanoma që kanë po atë ngjyrë si edhe lëkura (melanoma amelanotike) dhe për këtë shkak nuk bien në sy fare. Ndryshimet e dyshimta lëkurorë gjithmonë duhen sqaruar tek dermatologu, mjeku ose mjekja e lëkurës, pasi që sa

më herët të zbulohet një melanomë, aq më të mira janë shanset për shërim.

Diagnoza dhe ekzaminimet

Mjeku/mjekja e lëkurës fillimisht do të shqyrtojë me saktësi vendin e dyshimtë në lëkurë, mes tjerash edhe me ndihmën e një thjerrëze – dermatoskop. Po qe se ekziston dyshimi për një melanomë, njolla e dyshimtë lëkurore do të pritët nën një anestezi lokale dhe më pas do të ekzaminohet me saktësi në laborator. Për të konstatuar nëse tumori është përhapur tashmë në trup, sipas rrethanash do të zbatohen edhe ekzaminime të tjera, për shembull një scintigrafi e kockave ose një ultrasonografi e organeve të brendshme.

Stadet e sëmundjes

Sëmundjet e kancerit janë të ndara sipas sistemit TNM. Me këtë rast do të gjykohet përhapja e tumorit (T), invadimi i nyjave limfatike (N) dhe eventualisht edhe metastazat e pranishme (M). Melanoma, sipas sistemit TNM, ndahet si vijon:

T0	S'ka prani tumori
T1	Tumori është i trashë më pak se 1 mm
T2	Tumori është i trashë midis 1 dhe 2 mm
T3	Tumori është i trashë midis 2 dhe 4 mm
T4	Tumori është më i trashë se 4 mm
Tx	Shtrirja e tumorit nuk mund të gjykohet dot
N0	Nuk ka nyja të invaduar limfatike
N1	Është invaduar një nyjë limfatike
N2	Janë invaduar dy deri tre nyja limfatike
N3	Janë invaduar katër ose më shumë nyja limfatike
Nx	Invadimi i nyjave limfatike nuk mund të gjykohet
M0	S'ka prani metastazash
M1	Ka metastaza në organe të tjera, për shembull në mushkëri ose në eshtra
Mx	Prania e metastazave nuk mund të gjykohet

Në rastin e melanomës me rëndësi qenësore është që të përcaktohet trashësia e tumorit (ndarja sipas Breslovit) dhe që të përcaktohet se sa thellë ka depërtuar tashmë tumori në shtresa të veçanta lëkurore (thellësia invaduese sipas Klarkut). Sa më e trashë melanoma, aq më e madhe besueshmëria se ajo tashmë ka krijuar metastaza.

Terapia

Sapo të jetë konstatuar diagnoza, melanoma hiqet në rrugë operative. Me këtë rast do të hiqet edhe një copëz lëkure e shëndoshë përreth melanomës (distanca e sigurisë). Kështu shtohen shanset që qelizat kanceroze, të cilat eventualisht mund të gjenden në zonën në afërsi të melanomës, të mos mbeten në organizëm.

Përmasa e operacionit varet nga fakti se sa është zgjeruar tumori në thellësi të lëkurës – eventualisht duhen hequr edhe nyjat limfatike në zonën e melanomës.

Sipas stadi të tumorit, pas operacionit do të bëhet dhe një terapi imunizuese me substancën ndikuese interferon-alfa. Kjo substancë nxit sistemin imunitar të vetë organizmit që të luftojë ato qeliza kanceroze, të cilat mund të kenë mbetur akoma në organizëm. Në stadi të përparuar vëhet në përdorim edhe një kimioterapi ose radioterapi ose një kombinacion kimioterapie dhe radioterapie.

Pasoja e trajtimit

Pas heqjes së melanomës, në lëkurë mbetet një vragë, e cila, sipas rregullit, nuk përbën shqetësim.

Paskontrollet

Pas përfundimit të trajtimit të kancerit, pacientët duhet ta vizitojnë rregullisht mjekun e tyre për kontrolle të mëpasme. Ai do t'i japë secilit pacient rekomandime individuale se cilat kontrolle në cilin hark kohor janë të domosdoshme.

Faktorët rrezikues

Djegiet e përsëritura nga dielli – para së gjithash në fëmijëri – dhe ngarkesa e tepërt me rreze diellore (drita UV), shtojnë rrezikun për t'u sëmurur nga një melanomë. Te një numër pacientësh dhe pacientësh ekziston dhe një predispozitë trashëgimore që shton rrezikun nga melanoma.

Parandalimi dhe zbulimi i hershëm

Masa më e rëndësishme për parandalimin e kancerit të lëkurës është një mbrojtje efektive nga rrezet UV (Ultraviolet):

- > Të shmangët me çdo kusht djegia nga dielli
- > Midis orës 11 dhe 15, kur ngarkesa me rreze UV është më e madhe, të rrihet nën hije
- > Në diell të barten kapele, syzet diellore dhe rroba të përshtatshme.
- > Të përdoren kremra për mbrojtjen nga dielli me një faktor të lartë mbrojtës nga dielli
- > Foshnjat deri në moshën njëvjeçare të mos i ekspozohen kurrë drejtpërdrejt diellit.
- > Veçanërisht mirë të mbrohen fëmijët nga dielli.

la vlen që lëkurën ta kontrollojmë vetë në distanca të rregullta kohore dhe nishanet pigmentoze t'i vëzhgojmë me saktësi. Po qe se konstatohen ndryshime në nishane, ato duhen kontrolluar tek mjeku i lëkurës.

Shënim

Ky informacion mund të shkarkohet nga www.krebsliga.ch → Krebskrankheiten (Sëmundjet kanceroze) edhe në gjuhët gjermanisht, frëngjisht, italisht, spanjisht, portugalisht, serbisht-kroatisht-boshnjakisht dhe turqisht. Mos harroni dhe broshurat tona falas në gjermanisht, frëngjisht dhe italisht nën www.krebsliga.ch/broschueren.

Informacion, Këshillim, Mbështetje

Krebsliga Aargau

Tel. 062 834 75 75
www.krebsliga-aargau.ch

Krebsliga beider Basel

Tel. 061 319 99 88
www.krebsliga-basel.ch

Bernische Krebsliga Ligue bernoise contre le cancer

Tel. 031 313 24 24
www.bernischekrebssliga.ch

Ligue fribourgeoise contre le cancer

Krebsliga Freiburg
tél. 026 426 02 90
www.liguecancer-fr.ch

Ligue genevoise contre le cancer

tél. 022 322 13 33
www.lgc.ch

Krebsliga Glarus

Tel. 055 646 32 47
www.krebsliga-glarus.ch

Krebsliga Graubünden

Tel. 081 252 50 90
www.krebsliga-gr.ch

Ligue jurassienne contre le cancer

tél. 032 422 20 30
www.liguecancer-ju.ch

Ligue neuchâtoise contre le cancer

tél. 032 721 23 25
www.liguecancer-ne.ch

Krebsliga Schaffhausen

Tel. 052 741 45 45
www.krebsliga-sh.ch

Krebsliga Solothurn

Tel. 032 628 68 10
www.krebsliga-so.ch

Krebsliga St. Gallen- Appenzell

Tel. 071 242 70 00
www.krebsliga-sg.ch

Thurgauische Krebsliga

Tel. 071 626 70 00
www.tgkl.ch

Lega ticinese contro il cancro

tel. 091 820 64 20
www.legacancro-ti.ch

Ligue valaisanne contre le cancer

tél. 027 322 99 74
www.lvcc.ch

Krebsliga Wallis

Tel. 027 922 93 21
www.krebsliga-wallis.ch

Ligue vaudoise contre le cancer

tél. 021 641 15 15
www.lvc.ch

Krebsliga Zentralschweiz

Tel. 041 210 25 50
www.krebsliga.info

Krebsliga Zug

Tel. 041 720 20 45
www.krebsliga-zug.ch

Krebsliga Zürich

Tel. 044 388 55 00
www.krebsliga-zh.ch

Krebshilfe Liechtenstein

Tel. 00423 233 18 45
www.krebshilfe.li

Krebstelefon / Ligne Info- Cancer / Linea cancro

0800 11 88 11
Nga e hëna në të premten,
ora 10–18. Gjermanisht,
frenjgjisht, italisht; falas

migesplus

Schweizerisches Rotes Kreuz
3084 Wabern
Tel. 031 960 75 71
www.migesplus.ch
Informacione për migrante
dhe migrantë

Impressum

Autore

Dr. med. Eva Ebnöter,
Zollikon

Përkthimi

Bislim Elshani, migesplus

Ilustrimet

Daniel Haldemann, Wil SG

Botues

Krebsliga Schweiz
Effingerstrasse 40
Postfach 8219
3000 Bern
Telefon 031 389 91 00
www.krebsliga.ch

© 2010

Krebsliga Schweiz, Bern



Broshura u përpilua në kuadër të programit nacional të Entit federal për shëndetësi Migracioni dhe shëndetësia 2008–2013. www.migesplus.ch – Informacione shëndetësore në shumë gjuhë.